REPUBLIKA E KOSOVËS

KOMUNA E ISTOGUT

KONTRATË PËR PUNË

***KOMUNA E ISTOGUT** në vazhdim "Njësia e Prokurimit", të cilën e përfaqëson z. Gëzim Ademaj, menaxhere e Prokurimit, Rruga "Fadil Ferati" Nr. 121 në njërën anë;*

Dhe

***GRUPI I OE "BENITA COMPANY" & "ASFALT GROUP" Shpk** nga Komuna e Klinës të cilën e perfaqëson z. Emin Demaku, me Nr. Unik Rexh. Biznesi, 810313213 & 810082397 (ne vazhdim "Kontraktuesit"), ne anën tjetër, janë pajtuar te lidhin një kontratë publike për punë e shënuara me poshtë:*

TITULLI I KONTRATËS:

ASFALTIMI I RRUGËS SOKOL MEHMETAJ- LOT 4

Nr. I prokurimit	***633-20-6917 - 5-2-1/ C 419 LOT 4***
Nr. I brendshëm	***633 / 020 / 112 / 521***

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i furnizimeve dhe punëve në vijim nga ana e Kontraktuesit:

ASFALTIMI I RRUGËS SOKOL MEHMETAJ- LOT 4

2.1 Çmimi total i punëve per aktivitetin e prokurimit: ***ASFALTIMI I RRUGËS SOKOL MEHMETAJ- LOT 4 është: 8.550,00*** *€ dhe me fjalë:*
Tetëmijëepesëçindeepesëdhjetëeuro €

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve përgjatë ekzekutimit te kontratës.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës:

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

Marrëveshja e kontratës;
Kushtet e Veçanta të Kontratës;
Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
Oferta financiare (Paramasa dhe Parallogaria);
Plani për menaxhimin e kontratës

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 4 Afati i përmbushjës së kontratës:

4.1 Kontrata do të fillonë te realizohet pas nënshkrimit të sajë dhe do te përmbushet ne afat prej 30 ditë, nga data e nënshkrimit të së njëjtës, përkatesisht me së larti deri me: 25.12.2020

4.2 Në qoftë se Kontrata nuk permbushet ne afatin e paraparë, e njëjta do të ndërpritet dhe kompanija do të pergjigjet per demet eventuale qe mund t'i shkaktohen Autoritetit Kontraktues, sipas kushteve te përgjithshme dhe të veçanta të kontratës.

Neni 5 Komunikimet

5.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.

5.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

5.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim,

miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj "ose"vendosë "do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

5.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

Për: Autoritetin Kontraktues:
KOMUNA E ISTOGUT

Për: Kontraktuesin:
GOE "Benita Company"
&"Asfalt Group" Shpk

Emri:	***Gëzim Ademaj***	***Emri:***	***Hesen Kalludra***
Pozita:	***U.D.*** ***I Menaxher-it të Prokurimit***	***Pozita:***	***P r o n a r***
Nënshkrimi:		***Nënshkrimi:***	
Data:	26.11.2020	***Data:***	26.11.2020
Vu la		***V u l a***	

REPUBLIKA E KOSOVO
KOMUNA E ISTOGUT
OPSTINA ISTOK
REPUBLIKA KOSOVO

SHOQERIA E PERGJEGJESISE TE KUFIZUAR
BENITA COMPANY
SH.P.K.
102

	Specifikimi i punëve	Njësia	Sasia	Cmimi/ Njesi	Gjithsejt
KOMUNA E ISTOGUT					
TITULLI I AKTIVITETIT					
Lot 4 PARAMASA-Asfaltimi i rrugës Lagja Dervishaj-Zabllaq L=200m dhe gjerësi d=4m					
	Specifikimi i punëve	**Njësia (1)**	**Sasia (2)**	**Cmimi/ Njesi (3)**	**Gjithsejt (2x3)**
	Punët përgaditore				
1	Mobilizimi I ndermarrjes per fillimin e punimeve në projekt.Në çmim të llogaritet kosto e perpilimit të planit dhe programit punues si dhe gjithë kosto e transportit dhe vendosjes së makinave dhe stafit punues si dhe akomodimi I perkohshem I tyre	komplet	1.00	50.00	50.00
2	Demolimi I rrethojave metalike prej telave me gjemba dhe demolime te tjera te mundshme si shtylla etj,ngarkimi dhe bartja deri ne deponinë e qytetit deri ne 5km distancë	m'	20.00	2.00	40.00
3	Sanimi I trasës para fillimit të punimeve dhe gjatë ekzekutimit	m'	200.00	0.50	100.00
				subtotali	190.00
2	**Punimet e dheut**				
2.1	Germimi i dheut te kategorisë III-IV-të me ngarkim dhe bartje deri ne deponi ne largësi min 5km.Germimi të behet ne thellesi deri ne 25cm	m³	250.00	2.00	500.00
2.2	Rrafshimi i nenbazës me ngjeshje me vibrocilinder deri ne 30MN/m²	m²	1,000.00	0.50	500.00
2.3	Punimi i bankinave me trashësi t=10cm dhe gjeresi 0.5m me zhavor 0-31.5mm me ngjeshje-duke përfshirë perfshirë udhëkryqet dhe rrugët lidhëse me bankinen e rrugës	m³	20.00	8.00	160.00
				subtotali	1,160.00
3	**Mbistruktura**				
3.1	Punimi I tamponit 120MN/m² prej gurit të thyer gelqeror 0=63mm me trashësi t=15cm	m³	150.00	6.00	900.00
3.2	Punimi I tamponit 120MN/m² prej gurit të thyer gelqeror 0=32mm me trashësi t=10cm	m³	100.00	7.00	700.00
3.3	Furnizimi,bartja,shtrirja dhe ngjeshja e Asfalt betonit 0-16mm me trashesi t=7cm për terë siperfaqen e rrugës dhe atë me gjerësi 4m	m²	800.00	7.00	5,600.00
				subtotali	7,200.00
	TOTALI ME TE GJITHA NGARKESAT LOTO4				**8,550.00**



